



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**RREGULLORE**

**PËR**

**LICENCIMIN DHE FUNKSIONIMIN E PLATFORMËS SHUMËPALËSHE TË  
TREGTIMIT (PSHT), PLATFORMËS SË ORGANIZUAR TË TREGTIMIT (POT)  
DHE KËRKESAT PËR SHOQËRITË KOMISIONERE QË VEPROJNË SI  
INTERNALIZUES SISTEMATIKË**

*Miratur me Vendim Bordi nr. 88, datë 31 .05.2023*

**KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Qëllimi i rregullores**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave dhe procedurave për:

1. Dhënien e licencës për të operuar një platformë shumëpalëshe tregtimi (PSHT), apo një platformë të organizuar tregtimi (POT).
2. Mënyrën e organizimit dhe funksionimit/ushtrimit të veprimtarisë të platformës shumëpalëse të tregtimit (PSHT) apo platformës së organizuar të tregtimit (POT).
3. Kriteret për trajtimin/pushimin e shoqërisë komisionere si internalizues sistematik.

## **Neni 2**

### **Baza ligjore**

Kjo rregullore është hartuar në bazë dhe për zbatim të nenit 159, pika 5, nenit 161, pika 3, nenit 181, pika 1 dhe 3 të ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit, datë 14.05.2020, këtu e në vazhdim i referuar si “Ligji”.

## **Neni 3**

### **Fusha e zbatimit**

1. Kjo rregullore zbatohet nga operatorët e PSHT-së, siç përkufizohen në nenin 3, pika 69 dhe operatorët POT, siç përkufizohen në nenin 3, pika 73 të Ligjit.
2. Kreu VII i kësaj rregulloreje zbatohet nga shoqëritë komisionere dhe bankat që ofrojnë shërbime investimi, kur veprojnë si internalizues sistematikë.

## **Neni 4**

### **Përkufizimet**

Në këtë rregullore, termat që vijojnë do të kenë këto kuptime:

1. “**Aplikant**” është një operator tregu, që aplikon për licencë për të vënë në funksionim një PSHT ose një POT.
2. “**Operatori PSHT-së/OTP-së**” është një shoqëri komisionere ose bursë, që vë në funksionim një PSHT ose një POT.
3. “**Tregtim algoritmik**” është përdorimi i programeve kompjuterike, të cilat ekzekutojnë urdhëra, ku algoritmi (programi kompjuterik) vendos paraprakisht karakteristikat e urdhërit me ndërhyrje minimale/ose pa ndërhyrje njerëzore. Përdorimi i algoritmeve në procesin e pas-tregtimit (post trade) nuk nënkupton tregtim algoritmik.
4. “**Tregtim i bazuar në parimin e përputhjes së urdhrave**” – (Matched Principal Trading) është transaksioni në të cilin ndërmjetësi vendoset midis blerësit dhe shitësit të transaksionit në atë mënyrë që të mos ekspozohet asnjëherë ndaj riskut të tregut gjatë ekzekutimit të transaksionit, duke i ekzekutuar të dyja krahët e transaksionit në të njëjtën kohë (ndërmjet blerësit dhe shitësit) dhe ku transaksioni kryhet me një çmim ku ndërmjetësi nuk realizon fitim apo humbje, përveç një komisioni apo tarife, i cili është bërë i ditur më parë.
5. Të gjitha përkufizimet e tjera në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim si ato në Ligj.

## **KREU II**

### **KËRKESAT ORGANIZATIVE DHE OPERACIONALE PËR PSHT DHE POT**

#### **Neni 5**

#### **Kërkesa të përgjithshme për organizimin e një PSHT-je ose një POT-je në lidhje me aksesin në sistemin që operon**

1. Operatori i PSHT/POT-së miraton, zbaton dhe mban rregulla e procedura transparente për:
  - a) Të drejtën e aksesit në platformën që operon;
  - b) Kriteret për përcaktimin e instrumenteve financiare që mund të tregtohen në sistemet e saj;
  - c) Tregtimin;
  - d) Shlyerjen e transaksioneve.
2. Rregullat dhe procedurat e përmendura në pikën 1 të këtij neni u japin mundësi përdoruesve të përdorin sistemin në mënyrë efikase dhe të kuptojnë rreziqet e lidhura me përdorimin e platformës. Operatorit i kërkohet të vendosë rregulla jo diskriminuese që rregullojnë aksesin në platformën e tregtimit, të cilat nuk lejojnë asnjë diskrecion nga ana e operatorit. Rregullat duhet të parashikojnë që pjesëmarrësit e platformës të jenë shoqëri komisionere, banka që ofrojnë shërbime investimi, ose persona të tjerë të cilët:
  - a) Janë me reputacion të mirë dhe kanë integritetin, ndershmërinë dhe përkushtimin e duhur për të përmbushur detyrat e tyre.

Në vlerësimin e integritetit merret parasysh nëse personi:

- i. është në proces hetimor, gjyqësor, shpallur fajtor me vendim të formës së prerë për vepra penale kundër pasurisë ose krimit ekonomik apo vepra të tjera penale lidhur me shoqëritë tregtare, organizimin dhe vënien në funksionim të skemave mashtruese dhe piramidale të huamarrjes, si dhe pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;
    - ii. ka vepruar në kundërshtim me ndonjë nga kërkesat ligjore dhe standardet sipas legjislacionit në fuqi, ose me standardet apo kërkesat e ngjashme të autoriteteve të tjera rregullatore;
    - iii. është përjashtuar ose pezulluar nga një organ rregullator.
  - b) Kanë një nivel të mjaftueshëm aftësie, kompetence dhe përvojë, bazuar në evidencë, në lidhje me tregtimin e instrumenteve financiare të vlerësuar në kuadër të faktit se kanë kryer më parë aktivitete të ngjashme me një nivel të lartë përgjegjësie dhe pavarësie;
  - c) Kanë rregullime të përshtatshme organizative, kur është e aplikueshme; dhe

- d) Kanë burime të mjaftueshme për rolin që duhet të kryejnë, duke marrë në konsideratë marrëveshjet e nevojshme financiare që PSHT ose POT duhet të kenë për të garantuar shlyerjen e duhur të transaksioneve.
3. Operatori duhet të vendosë kritere të mëtëjshme që duhet të plotësohen për t'u bërë pjesëmarrës i PSHT-së/ POT-së.
  4. Operatori vë në dispozicion të pjesëmarrësve të platformës të gjitha informacionet e nevojshme dhe të rëndësishme për përdorimin e platformës së tregtimit, duke marrë në konsideratë llojin e përdoruesve dhe llojet e instrumenteve financiare të tregtuara.

## **Neni 6**

### **Kriteret për përcaktimin e instrumenteve financiare që mund të tregtohen**

1. Në mbështetje të nenit 161, pika 1, shkronja b) dhe nenit 163 të Ligjit, një operator miraton, zbaton dhe mban rregulla dhe procedura transparente lidhur me kriteret për përcaktimin e instrumenteve financiare që mund të tregtohen në sistemet e tij.
2. Instrumentet financiare të përcaktuara në nenin 3, pika 40 të Ligjit, mund të tregtohen në një PSHT.
3. Instrumentet financiare të përcaktuara në nenin 3, pika 73 të Ligjit, mund të tregtohen në një POT.
4. Instrumentet e strukturuar që mund të pranohen për tregtim nga një POT duhet të jenë krijuar vetëm nga shoqëritë komisionere apo bankat që ofrojnë shërbime investimi.
5. Operatori i një POT-je, në çdo kohë dhe sipas vlerësimit të tij, mund të shtojë ose heqë instrumentet financiare të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni.
6. Operatori i një POT-je duhet të ketë rregulla dhe procedura për kriteret e përcaktimit të instrumenteve financiare që pranohen për tregtim.

## **Neni 7**

### **Kërkesat në lidhje me procesin e tregtimit dhe finalizimin e transaksioneve në një PSHT/POT**

1. Operatori i PSHT/POT miraton, zbaton dhe mban rregulla dhe procedura transparente në lidhje me tregtimin.
2. Operatori përcakton rregulla për sigurimin e një tregtimi dhe caktim çmimesh të drejtë e të rregullt, përfshirë çmimet e referencës, si dhe ekzekutim efikas të urdhrave. Rregullat e tregtimit dhe të përcaktimit të çmimeve nuk i lejojnë operatorit të PSHT-së të bëjë vlerësime diskrecionale.
3. Operatori përcakton rregulla për të mundësuar shlyerjen efikase të transaksioneve të kryera në përputhje me kontratën, marrëveshjen ose sipas përcaktimeve të urdhrave në tregtim. Operatori njofton në mënyrë të qartë përdoruesit për përgjegjësitë e tyre për shlyerjen e transaksioneve të ekzekutuara në këtë platformë.

4. Operatori miraton rregulla dhe procedura efektive për monitorimin e rregullt të përputhshmërisë së përdoruesve me parashikimet e këtij ligji, me aktet nënligjore të miratuara në zbatim të ligjit dhe rregullat e platformës shumëpalëshe të tregtimit.
5. Operatori miraton dhe zbaton rregulla dhe procedura efektive për monitorimin e rregullt të transaksioneve të kryera nga përdoruesit e platformës, me qëllim identifikimin e shkeljeve të mundshme të rregullave, kushteve të parregullta të tregtimit ose sjelljeve që përbëjnë abuzim të tregut.
6. Operatori mund të vendosë tarifa të veçanta/specifike në rastin e një numri të lartë urdhrash, të vendosura në një ditë normale tregtimi, modifikimeve dhe anulimeve të urdhrave. Niveli i këtyre tarifave duhet të përcaktohet në mënyrë të tillë që ato të reduktojnë/minimizojnë në mënyrë efikase përdorimin e tepërt dhe efektet negative që lidhen me stabilitetin sistematik ose integritetin e tregut.
7. Strukturat e tarifave, duke përfshirë tarifat e ekzekutimit, tarifat dytësore dhe çdo zbritje/skonto duhet të jenë transparente dhe jodiskriminuese. Tarifat duhet të jenë të tilla që të mos krijojnë stimuj për të vendosur, modifikuar ose anuluar urdhrat ose për të ekzekutuar transaksione të cilat shkaktojnë kushte të parregullta të tregtimit ose përbëjnë abuzim me tregun.
8. Operatori duhet të marrë masat e duhura për të mbrojtur përcaktimin e rregullt të çmimit edhe në rast të luhatjeve të konsiderueshme të çmimeve, duke përfshirë në veçanti:
  - a) Ndryshimet afatshkurtra në modelin e tregut,
  - b) Ndërprerjet e përkohshme për të reduktuar luhatshmërinë, duke marrë në konsideratë ndryshimet statike ose dinamike të çmimeve dhe sistemet kufizuese të pjesëmarrësve tregtues të ngarkuar me detyrën e përcaktimit të çmimit, megjithëse operatori mund të anulojë, modifikojë ose korrigjojë çfarëdo transaksioni në raste të jashtëzakonshme.

Parametrat për ndërprerjet e tregtimit për shkak të luhatshmërisë duhet të marrin parasysh likuiditetin e kategorive dhe nënkategorive individuale të instrumenteve financiare në fjalë, llojin e modelit të tregut dhe llojin e përdoruesve dhe duhet të lejojnë që të parandalohen ndërprerje të rëndësishme të tregtimit të rregullt. Operatori informon Autoritetin për këto parametra.
9. Operatori duhet të sigurojë kontrollet dhe kufijtë e duhur të rrezikut në lidhje me tregtimin që kryhet nëpërmjet aksesit elektronik të drejtpërdrejtë dhe në veçanti të vendosë rregulla për :
  - a) Urdhra të veçantë të lëshuar, duke përdorur aksesin elektronik të drejtpërdrejtë, dhe
  - b) Ndalimin e tregtimit ose dhënien fund të aksesit të drejtpërdrejtë elektronik në çdo kohë, nëse zotëruesi i aksesit të drejtpërdrejtë elektronik shkel dispozitat ligjore në fuqi.
10. Operatori duhet të përcaktojë rregullat për dallimin e çdo urdhri të gjeneruar nga tregtimi algoritmik nga pjesëmarrësit në sistemin e tregtimit dhe për zbulimin e algoritmeve të tregtimit që përdoren për këtë qëllim dhe të personave që iniciuan këto urdhra.

11. Operatori duhet të sigurojë administrim të qëndrueshëm të operacioneve teknike të platformës të tregtimit, në veçanti:
  - a) Të marrë masa efikase në rast mosfunksionimi të sistemit ose ndërprerjeve të sistemeve të tij të tregtimit për të siguruar vazhdimësinë e veprimtarive të biznesit,
  - b) Të sigurojë që sistemet e tregtimit të jenë elastike dhe të kenë kapacitete të mjaftueshme për të përballuar volumet e urdhrave dhe mesazheve edhe në periudha të ngarkuara,
  - c) Të sigurojë që sistemet mund të vazhdojnë tregtimin e rregullt edhe në kushte ekstreme apo situata stresi dhe se janë testuar plotësisht për të siguruar që këto kushte janë përmbushur.
12. Operatori duhet të ketë në dispozicion masa për të identifikuar qartë dhe për të menaxhuar pasojat e mundshme negative për funksionimin e duhur të PSHT-së/ POT-së, duke përfshirë aksionarët e tij dhe pjesëmarrësit në treg.
13. Operatori duhet të sigurojë që PSHT-ja/ POT-ja të ketë të paktën tre anëtarë ose përdorues aktivë dhe secili prej tyre të ketë mundësinë të ndërveprojë me të gjithë anëtarët dhe përdoruesit e tjerë në lidhje me formimin e çmimit.
14. Operatori miraton, zbaton dhe mban rregulla dhe procedura transparente në lidhje me shlyerjen e transaksioneve.

## **Neni 8**

### **Kërkesat specifike për operatorët e PSHT**

1. Rregullat për tregtimin dhe përcaktimin e çmimit nuk mund t'i japin operatorit të një PSHT-je asnjë diskrecion, bërja publike e çmimit në PSHT duhet të korrespondojë me situatën reale të tregut.
2. Çdo shoqëri që operon një PSHT duhet të marrë masa efektive dhe të përshtatshme për të ndarë nga ana organizative këtë aktivitet nga aktivitetet e tjera të saj.
3. Operatori i një PSHT-je duhet të ketë procedura dhe të marrë masa për të menaxhuar në mënyrën e duhur rreziqet ndaj të cilave është i ekspozuar dhe në veçanti për të identifikuar të gjitha rreziqet e rëndësishme për funksionimin e platformës të tregtimit dhe për të zbutur në mënyrë efikase ato rreziqe, si dhe për të lehtësuar finalizimin efikas dhe në kohë të transaksioneve të kryera sipas sistemeve të tij.
4. Operatori i një PSHT-je duhet të ketë në dispozicion në mënyrë të vazhdueshme burime të mjaftueshme financiare, siç përcaktohen në rregulloret përkatëse në fuqi për mjaftueshmërinë e kapitalit, në varësi të operatorit (shoqëri komisionere apo bursë), për të garantuar funksionimin e rregullt të platformës, duke pasur parasysh natyrën dhe shtrirjen e transaksioneve që zbatohen në sistemin e tregtimit dhe gamën dhe shkallën e rreziqeve ndaj të cilave ajo ekspozohet.
5. Operatori i një PSHT-je nuk lejohet të ekzekutojë urdhra klientësh kundrejt kapitalit të zotëruesit ose të angazhohet në tregtimin e bazuar në parimin e përputhjes së urdhrave.

## **Neni 9**

### **Kërkesat specifike për operatorët e POT-ve**

1. Operatori i një POT-je duhet të marrë masa që parandalojnë ekzekutimin e urdhrave të klientit në një POT kundrejt kapitalit të zotëruar të operatorit ose të një subjekti, pjesë e të njëjtit grup me operatorin.
2. Operatori i një POT-je mund të angazhohet në tregtimin për llogari të vet, krahas tregtimit të bazuar në parimin e përputhjes së urdhrave, vetëm në lidhje me instrumentet e borxhit sovran për të cilët nuk ka një treg likuid.
3. Operatori i një POT-je mund të angazhohet në tregtimin e bazuar në parimin e përputhjes së urdhrave për obligacione, produkte të strukturuar financiare, kuotat e lejuara të çlirimit të gazrave serrë dhe derivativët vetëm kur klienti ka dhënë miratimin për këtë proces.
4. Një platformë e organizuar tregtimi (POT) dhe një internalizues sistematik nuk mund të operohen nga i njëjti person juridik. POT-ja nuk duhet të ndërlidhet me një internalizues sistematik ose një POT tjetër, në një mënyrë që mundëson ndërveprimin e urdhrave në POT me urdhrat ose kuotimet në internalizuesin sistematik ose POT.
5. Operatori i një POT-je mund të angazhojë një shoqëri komisionere/bankë që kryen shërbime investimi për t'u përfshirë në krijimin e tregut në mënyrë të pavarur nga operatori i POT-së. Krijimi i tregut kryhet në mënyrë të pavarur vetëm nëse nuk ka lidhje të ngushta mes shoqërisë komisionere /bankës dhe operatorit të POT-së. Shoqëria komisionere nuk do të konsiderohet se po kryen krijimin e tregut në një POT në mënyrë të pavarur, nëse ajo ka lidhje të ngushta me shoqërinë komisionere që operon POT.
6. Operatori i një POT-je mund të ushtrojë diskrecion në lidhje me vendimin për të ekzekutuar një urdhër në një POT, kur ai vendos ose anulon një urdhër, ose nuk lejon përputhjen e një urdhëri të caktuar të klientit me urdhrat e tjerë të disponueshëm në sistem në një kohë të caktuar në përputhje me instruksionet specifike të marra nga klienti.
7. Ushtrimi i diskrecionit lidhur me urdhërat apo me ekzekutimin e tyre duhet të parashikohet nga operatori i POT në rregullat e tij si dhe në politikën e ekzekutimit më të mirë.
8. Kur shoqëria komisionere operon edhe një POT, ajo duhet të zbatojë një politikë të ekzekutimit më të mirë, ku caktohen të gjitha vendet e mundshme për ekzekutimin e urdhërave, përfshirë edhe vetë platformën POT që operon shoqëria, duke argumentuar se në cilat rrethana një vend tregtimi ka përparësi ndaj një vendi tjetër në ekzekutimin më të mirë të urdhërave të klientit.
9. Përveç sa parashikuar në pikën 8 të këtij neni, shoqëria komisionere që operon një POT duhet të ketë një politikë të veçantë për ekzekutimin më të mirë të urdhërave në një POT, ose në politikën e saj të përgjithshme të ekzekutimit më të mirë të përfshijë një seksion të posaçëm për ekzekutimin më të mirë të urdhërti në një POT. Politika duhet të përcaktojë se si do të merret rezultati më i mirë i mundshëm për klientin në rast se urdhëri vendoset në POT.
10. Kërkesa e parashikuar në pikën 9 të këtij neni vlen edhe për rastin kur platforma POT operohet nga një operator tregu, i përcaktuar sipas Ligjit. Në këtë rast operatori i tregut duhet të ketë politikë të ekzekutimit më të mirë të urdhërave, ku të përcaktohen kushtet në

të cilat një urdhër i marrë nga klienti mund të ekzekutohet në platformën POT të këtij operatori tregu.

11. Operatori i një POT-je duhet të ketë në dispozicion në mënyrë të vazhdueshme burime të mjaftueshme financiare, siç përcaktohen në rregulloret përkatëse në fuqi për mjaftueshmërinë e kapitalit, në varësi të operatorit (shoqëri komisionere apo bursë), për të garantuar funksionimin e rregullt të platformës, duke pasur parasysh natyrën dhe shtrirjen e transaksioneve që zbatohen në sistemin e tregtimit dhe gamën dhe shkallën e rreziqeve ndaj të cilave ajo ekspozohet.
12. Operatori i një POT-je duhet t'i japë Autoritetit, me kërkesë të tij, në çdo kohë, dhe veçanërisht në rastin e aplikimit të tij për të operuar një POT, një shpjegim të detajuar pse platforma po konsiderohet/trajtohet si POT dhe jo si një treg i rregulluar, një PSHT apo një internalizues sistematik. Shpjegimi duhet të përmbajë një përshkrim të detajuar se si do të ushtrohet diskrecioni, veçanërisht kur një urdhër për POT-në mund të anulohet dhe si do të përputhen dy ose më shumë urdhra klientësh brenda POT-së. Gjithashtu, operatori i një POT-je duhet t'i japë Autoritetit informacione që shpjegojnë përdorimin nga ana e tij të tregtimit të bazuar në parimin e përputhjes së urdhrave.
13. Autoriteti monitoron angazhimin e operatorit të POT-së në tregtimin e bazuar në parimin e përputhjes së urdhrave për të siguruar që ai vazhdon të përfshihet në një tregtimi të tillë dhe që angazhimi i tij në tregtimin e bazuar në parimin e përputhjes së urdhrave të mos shkaktojë konflikt interesi midis operatorit dhe klientëve të tij.

### **KREU III LICENCIMI I PSHT/POT**

#### **Neni 10**

#### **Dhënia e licencës për të operuar platformën shumëpalëshe të tregtimit (PSHT) apo platformën e organizuar të tregtimit (POT)**

1. Platforma shumëpalëshe e tregtimit (PSHT) dhe platforma e organizuar e tregtimit (POT) mund të operohen nga një shoqëri komisionere ose një bursë vetëm pas autorizimit të dhënë nga Autoriteti.
2. Shoqëria komisionere ose bursa, që synon të operojë një platformë shumëpalëshe tregtimi (PSH) apo një platformë të organizuar tregtimi (POT) i drejtohet Autoritetit me një kërkesë për licencë, së cilës i bashkëlidh informacion për:
  - a) Sistemin e tregtimit;
  - b) Aksesueshmërinë e të dhënave në lidhje me ofertat, kërkesat dhe të dhënat e tregtimit, të destinuara për përdoruesit dhe publikun;
  - c) Përdoruesit e mundshëm të sistemit;



- d) Instrumentet financiare që mund të tregtohen brenda sistemit;
  - e) Mekanizmat dhe metodat e shlyerjes së transaksioneve;
  - f) Masat që do të sigurojnë përputhshmërinë me dispozitat e këtij ligji dhe me aktet nënligjore të miratuara në zbatim të këtij ligji.
3. Shoqëria komisionere ose bursa, që synon të operojë një platformë shumëpalëshe tregtimi (PSHT) apo platformë të organizuar tregtimi (POT), i bashkëlidh kërkesës së përmendur në pikën 1 të këtij neni rregulloret e platformës së tregtimit.
  4. Shoqëria komisionere ose bursa, që synon të operojë një platformë shumëpalëshe tregtimi (PSHT), apo platformë të organizuar tregtimi (POT) i vërteton Autoritetit se:
    - a) Ka marrë masat e duhura për të administruar rreziqet ndaj të cilave ekspozohet, për të zbatuar masat dhe sistemet e duhura për identifikimin e të gjitha rreziqeve të rëndësishme të aktivitetit dhe për të zbutur rreziqet e mundshme;
    - b) Ka marrë masat e duhura për të mundësuar finalizimin efikas dhe në kohë të transaksioneve të kryera në sistemet e saj; dhe
    - c) Zotëron në momentin e licencimit dhe do të ruajë në vijimësi burime të mjaftueshme financiare për të mundësuar funksionimin e rregullt të saj, duke mbajtur parasysh natyrën dhe shtrirjen e shërbimeve të ofruara, si dhe gamën e shkallën e rreziqeve, ndaj të cilave ekspozohet.
  5. Operatori i PSHT/POT-së njofton pa vonesë Autoritetin për çdo ndryshim në të dhënat e njoftuara në zbatim të këtij neni.

## **Neni 11**

### **Dokumentacioni dhe informacionet në lidhje me evidencën e përputhshmërisë me kriteret e licencimit sipas Ligjit dhe kësaj rregulloreje**

1. Aplikanti duhet t'i provojë Autoritetit, duke ofruar dokumentacion dhe informacione, në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 159, pikat 3 e 5, si dhe në nenin 161, pika 1 të Ligjit dhe kriteret specifike të përcaktuara nga neni 5 deri në 8 të kësaj rregulloreje. Aplikanti i bashkëngjit kërkesës së tij për licencë për të operuar një PSHT ose POT:
  - a) Rregulloren që do të aplikohet për funksionimin e një PSHT-je ose një POT-je. Rregullorja duhet të përmbajë minimalisht: instrumentet financiare që tregtohen në PSHT ose POT; Rregullat dhe procedurat lidhur me pranimin për tregtim dhe mënyrën si dhe ku ky informacion vihet në dispozicion të publikut;
  - b) Rregullat dhe procedurat për të siguruar aksesin objektiv dhe jo diskriminues në platformat e tregtimit, së bashku me detajet mbi marrëveshjet e publikimit të përdorura për ta bërë atë informacion të disponueshëm për publikun;

- c) Masat dhe procedurat për të siguruar që përdoruesit e PSHT-së ose POT-së të kenë informacion të mjaftueshëm publikisht për të formuar një gjykim investimi, duke marrë parasysh si natyrën e përdoruesve, ashtu edhe klasat e instrumenteve financiare të tregtuara;
  - d) sistemet, procedurat dhe rregulla/marrëveshje për të siguruar se sistemet e tregtimit janë:
    - i. të qëndrueshme;
    - ii. kanë kapacitet të mjaftueshëm për të përballuar urdhërat dhe volumet e mesazheve në kohë piku;
    - iii. mund të sigurojnë vazhdimësinë e tregtimit të rregullt në kushtet e situatave të stresit në treg;
    - iv. janë testuar plotësisht për të siguruar plotësimin e kritereve të përmendura në pikat më sipër të këtij paragrafi;
    - v. janë subjekt i procedurave efikase që sigurojnë vazhdimësinë e biznesit në mënyrë që të vijohet me ofrimin e shërbimeve të tij edhe nëse ka ndonjë mosfunksionim të sistemeve të tij të tregtimit;
    - vi. dokument mbi bazën e të cilit vërtetohet se është kryer certifikimi i sistemit;
    - vii. evidencë për efektivitetin dhe sigurinë e sistemit;
    - viii. marrëveshje e nënshkruar me shoqërinë që ofron sistemin e tregëtimit për realizimin e shërbimit;
  - e) Masat dhe procedurat për monitorimin e transaksioneve;
  - f) Rregullat dhe procedurat për pezullimin dhe heqjen e instrumenteve financiare nga tregtimi;
  - g) Masat që evidentojnë se janë në përmbushje të detyrimeve të transparencës para tregtimit dhe pas tregtimit në përputhje me nenin 168 dhe 170 të ligjit;
  - h) Një listë të anëtarëve ose pjesëmarrësve të PSHT-së ose POT-së që ai operon, shoqëruar me një letër angazhimi të secilit prej anëtarëve ose përdoruesve të PSHT-së ose POT-së;
  - i) Kontratën tip që do të lidhet ndërmjet shoqërisë komisionere ose operatorit të tregut dhe anëtarit ose pjesëmarrësit të PSHT-së ose POT-së.
2. Krahas dokumenteve të nevojshme sipas paragrafit 1 të këtij neni, Aplikanti duhet t'i bashkëngjisë kërkesës së tij për licencë një përshkrim të detajuar të funksionimit të sistemit të tij të tregtimit duke specifikuar:
- a) Nëse sistemi përfaqëson një funksionalitet zanor, elektronik ose hibrid;
  - b) Në rastin e një sistemi elektronik tregtimi ose hibrid, natyrën e çfarëdo algoritmi ose programi që përdoret për të përcaktuar përputhjen dhe ekzekutimin e interesave tregtare;

- c) Në rastin e një sistemi tregtimi me zë, rregullat dhe protokollet që përdoren për të përcaktuar përputhjen dhe ekzekutimin e interesave të tregtimit;
  - d) Një përshkrim që shpjegon se si sistemi i tregtimit plotëson çdo element të përkufizimit të një PSHT-je ose një POT-je.
3. Aplikanti duhet t'i japë Autoritetit informacione se si dhe në cilat raste funksionimi i PSHT-së ose POT-së do të shkaktojë ndonjë konflikt të mundshëm midis interesave të PSHT-së ose POT-së, operatorit të tij ose zotëruesve të tij dhe funksionimit të duhur të PSHT-së ose POT-së.
  4. Aplikanti duhet t'i ofrojë Autoritetit informacione për çdo lidhje ose pjesëmarrje në një treg të rregulluar, PSHT, POT, ose internalizues sistematik që zotërohet nga aplikanti.
  5. Nëse aplikanti aplikon për licencë për të operuar një PSHT dhe POT, aplikanti duhet t'i japë Autoritetit informacionet shtesë të mëposhtme:
    - a) Një përshkrim të masave dhe sistemeve që zbatohen për të administruar rreziqet ndaj të cilave operatori është i ekspozuar, për të identifikuar të gjitha rreziqet e rëndësishme për funksionimin e tij dhe për të vendosur masa efektive për të zbutur ato rreziqe;
    - b) Një përshkrim të masave që zbatohen për të lehtësuar finalizimin efikas dhe në kohë të transaksioneve që kryhen sipas sistemeve të operatorit në përputhje me nenin 165 të ligjit;
    - c) Duke pasur parasysh natyrën dhe shtrirjen e transaksioneve që kryhen në treg dhe gamën dhe shkallën e rreziqeve ndaj të cilave operatori është i ekspozuar, një përshkrim të burimeve financiare që konsiderohen të mjaftueshme për të lehtësuar funksionimin e rregullt të tij.
  6. Nëse aplikanti aplikon për një licencë për të operuar një POT, aplikanti duhet t'i japë Autoritetit informacionet shtesë të mëposhtme:
    - a) Informacione nëse një tjetër shoqëri komisionere është e angazhuar për të kryer krijimin e tregut në POT-në e saj në mënyrë të pavarur;
    - b) Një përshkrim të detajuar sesi dhe në çfarë rrethanash ai ekzekuton urdhrat në POT në mënyrë diskrete;
    - c) Rregullat, procedurat dhe protokollet që lejojnë operatorin të drejtojë interesin tregtar të një anëtari ose pjesëmarrësi jashtë platformave të POT-së;
    - d) Një përshkrim të përdorimit të tregtimit të bazuar në parimin e përputhjes së urdhrave, i cili nuk do të shkaktojë konflikt interesi midis operatorit dhe klientëve të tij;
    - e) Një përshkrim të procedurës së brendshme për parandalimin dhe zbulimin e tregtimit të bazuar në informacionin e privilegjuar dhe manipulimit të tregut në përputhje me rregulloren për ndalimin e abuzimit me tregun.
  7. Shoqëria komisionere ose operatori i tregut që operon një POT do të ushtrojë diskrecionin në përputhje me paragrafin 6, shkronja b) të këtij neni vetëm në njërin ose të dyja rrethanat e mëposhtme:

- a) Kur vendosin të japin ose të tërheqin një urdhër në POT-në që ata operojnë;
- b) Kur vendosin të mos përputhin një urdhër specifik klienti me urdhrat e tjerë të disponueshëm në sisteme në një kohë të caktuar, me kusht që të jetë në përputhje me udhëzimet specifike të marra nga një klient. Për sistemin që kryqëzon urdhrat e klientëve, shoqëritë komisionere ose operatori i tregut që operon POT-e mund të vendosë nëse, kur dhe sa nga dy ose më shumë urdhra dëshiron të përputhë brenda sistemit. Në lidhje me një sistem që rregullon transaksionet në intrumente financiare të cilat nuk janë aksione, shoqëria komisionere ose operatori i tregut që operon POT-në mund të lehtësojë negocimin midis klientëve në mënyrë që të bashkojë dy ose më shumë interesa tregtimi potencialisht të pajtueshme në një transaksion të vetëm.

## **Neni 12**

### **Formë-Kërkesa**

1. Kërkesa për licencim si platformë shumëpalëshe tregëtimi apo si platformë e organizuar tregëtimi bëhet sipas Shtojcës I të kësaj rregulloreje, shoqëruar nga dokumentacioni i kërkuar.
2. Formë-kërkesa plotësohet dhe nënshkruhet nga përfaqësuesi/t ligjor/ë i shoqërisë komisionere/ bursës.
3. Shtojca I, plotësohet në format elektronik dhe dorëzohet e printuar në format A4 në të gjitha rubrikat e saj, në mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe pa korrigjime.
4. Kur aplikanti i jep Autoritetit përshkrimin e funksionimit të PSHT-së ose POT-së që operon siç përcaktohet në këtë rregullore, aplikanti duhet të përfshijë referenca të qarta në dokumentin që paraqet, të cilat plotësojnë kriteret e modelit të paraqitur në Shtojcën I.
5. Shoqëritë komisionere që aplikojnë për të operuar një PSHT ose POT duhet të dorëzojnë gjithashtu informacionet e nevojshme në përputhje me rregulloren për “Licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërive të huaja komisionere”, që lidhen me funksionin e PSHT apo POT.
6. Në dhënien e informacioneve të nevojshme sipas kësaj rregulloreje, aplikanti duhet të përfshijë referenca për dispozitat përkatëse të rregullave të PSHT-së ose POT-së, marrëveshje ose kontrata me pjesëmarrësit ose palët e treta përkatëse, si dhe procedura dhe politika të brendshme.
7. Aplikanti duhet t’i japë Autoritetit informacionet e nevojshme në formë të shkruar.

## **KREU IV SHQYRTIMI DHE MIRATIMI I APLIKIMIT**

### **Neni 13**

#### **Afati i trajtimit të kërkesës dhe shqyrtimi i dokumentacionit**

1. Autoriteti, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës, shqyrton kërkesën dhe listën e dokumenteve të depozituara për licencim sipas Ligjit dhe kësaj rregulloreje.
2. Autoriteti, nëse vëren se kërkesa e dorëzuar nuk përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar, i kërkon subjektit me shkrim ose në mënyrë elektronike, që brenda 10 (dhjetë) ditëve pune të plotësojë kërkesën duke specifikuar dokumentet që mungojnë.
3. Nëse subjekti për arsye të argumentuara nuk është në gjendje të paraqesë ndonjë nga dokumentet brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve pune, Autoriteti kur e shikon të arsyeshme mund të zgjasë afatin edhe me 10 (dhjetë) ditë pune të tjera. Nëse subjekti kërkuar nuk dorëzon dokumentet e kërkuara brenda afatit të përcaktuar në këtë nen, Autoriteti refuzon kërkesën si të paplotë dhe njofton subjektin kërkuar për refuzimin e kërkesës, duke dhënë argumentet përkatëse.
4. Gjatë periudhës së shqyrtimit, Autoriteti mund të kërkojë çdo informacion të mëtejshëm që është i nevojshëm për të gjykuar mbi plotësimin e kriterëve nga subjekti kërkuar.
5. Kërkesa për plotësim dokumentacioni dhe/ose përmirësim i përmbajtjes së dokumenteve të depozituara, i komunikohet subjektit me shkrim ose në mënyrë elektronike.
6. Gjatë periudhës së shqyrtimit, Autoriteti vlerëson:
  - a) Përputhshmërinë e subjektit kërkuar me kërkesat e Ligjit dhe të kësaj rregulloreje;
  - b) Aftësinë e subjektit kërkuar për të ruajtur dhe plotësuar në të ardhmen kushtet e licencimit.
7. Autoriteti njofton aplikuesin për vendimin e tij në lidhje me miratimin e kërkesës brenda 3 (tre) muajsh nga data e paraqitjes së dokumentacionit të plotë.

### **Neni 14**

#### **Refuzimi dhe heqja e licencës**

1. Autoriteti nuk miraton kërkesën për licencë si platformë shumëpalëshe tregtimi apo si platformë të organizuar tregtimi nëse subjekti kërkuar nuk përmbush ndonjë prej kushteve të përcaktuara në Ligj dhe në këtë rregullore.
2. Autoriteti mund të heqë licencën e subjektit që operon një PSHT ose POT nëse ky subjekt:

- a) Nuk ka vënë në funksionim platformën dhe/ose nuk ka siguruar numrin minimal të pjesëmarrësve të platformës brenda 12 muajve nga data e licencës;
- b) Heq dorë shprehimisht nga licenca;
- c) Ka marrë licencën duke bërë deklaratë të rreme ose me çfarëdo mjeti tjetër të parregullt, ose
- d) Nuk i plotëson më kriteret, sipas të cilave është dhënë licenca.

## **KREU V DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 15**

#### **Detyrimet e aplikantëve dhe dispozitat e mëtejshme të zbatueshme**

1. Operatori duhet të njoftojë në Autoritet çdo ndryshim material në informacionet e paraqitura më parë në aplikimin e tij dhe të kërkuara sipas Ligjit dhe kësaj rregulloreje.
2. Kur operatori i dërgon një informacion të ri Autoritetit për të korrigjuar, përditësuar ose sqaruar informacionet e paraqitura më parë në përputhje me këtë rregullore, ai nuk duhet të përfshijë informacione që janë të një natyre të vogël ose teknike, të cilat nuk do të ishin të rëndësishme për një vlerësim të përputhshmërisë së tyre me nenin 11 të kësaj rregulloreje.
3. Autoriteti miraton çdo ndryshim të rregullave të operatorit të përcaktuara në nenin 5, pika 1, të kësaj rregulloreje.
4. Operatori duhet të njoftojë pa vonesë Autoritetin për çdo shkelje të rëndë të rregullave të tregtimit, çënimit të integritetit të tregut dhe në rast se ka sinjale/indikacione për shkelje të kritereve të ligjit apo rregullores në fuqi për abuzimin me tregun si dhe t'i japë Autoritetit çdo informacion të kërkuar në mbështetje të hetimeve të tij.

## **KREU VI**

### **Komunikimi dhe publikimi i pezullimit dhe heqjes së instrumenteve financiare të PSHT-ve dhe POT-ve**

#### **Neni 16**

##### **Pezullimi dhe heqja e instrumenteve financiare**

1. Operatori nuk duhet të ushtrojë kompetencën e tij për të pezulluar apo hequr nga tregtimi ndonjë instrument financiar, i cili nuk është më në përputhje me rregullat e tij, kur një hap i tillë mund të shkaktojë dëm në interesin e investitorëve apo për funksionimin normal të vendit të tregëtimit.
2. Kur operatori pezullon apo heq nga tregtimi një instrument financiar, duhet të heqë gjithashtu edhe instrumentin derivativ që lidhet me atë instrument.
3. Vendimi i operatorit për të pezulluar/hequr një instrument financiar duhet të bëhet menjëherë publik përmes faqes së internetit të operatorit si dhe të njoftohet njëkohësisht Autoriteti për këtë vendim.

#### **Neni 17**

##### **Formati i publikimeve dhe komunikimeve**

1. Operatori i PSHT apo POT i komunikon Autoritetit vendimin sipas formatit të Shtojcës II të kësaj rregulloreje.
2. Kur vendimi për pezullim nga tregtimi merret nga Autoriteti, publikimi i vendimit bëhet sipas formatit të Shtojcës III të kësaj rregulloreje
3. Autoriteti publikon menjëherë vendimin e referuar në paragrafin 2 të këtij neni.

**KREU VII**  
**INTERNALIZUESI SISTEMATIK**

**SEKSIONI I**

**Treguesit dhe kufijtë e paracaktuar për trajtimin e shoqërisë komisionere si  
Internalizues Sistematik**

**Neni 18**

**Trajtimi i shoqërisë si Internalizues Sistematik**

1. Shoqëria komisionere, e cila në mënyrë të organizuar, të shpeshtë dhe sistematike vepron për llogari të vet duke ekzekutuar urdhrat e klientëve në instrumente financiare jashtë një tregu të rregulluar ose një platforme shumëpalëshe tregtimi, ose një platforme të organizuar tregtimi duhet të trajtohet si internalizues sistematik në kuptim të Ligjit dhe kësaj rregulloreje, nëse janë kaluar/kapërcyer kufijtë e paracaktuar për shpeshësinë dhe sistematikën, përcaktuar në nenet 19 deri 23 të kësaj rregulloreje, duke njoftuar Autoritetin për përmbushjen e kësaj pike. Treguesi i shpeshësisë dhe ai sistematik vlerësohen duke u bazuar në numrin e transaksioneve mbi banak të instrumenteve financiare, që kryhen nga shoqëria komisionere për llogari të vet gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientëve, ose kur shoqëria komisionere vendos vullnetarisht të përfshihet në regjimin e internalizuesit sistematik. Në këtë rast shoqëria komisionere njofton paraprakisht Autoritetin lidhur me synimin e saj për të marrë në mënyrë vullnetare statusin e internalizuesit sistematik.
2. Njoftimet e përmendura në pikën 1 të këtij neni duhet të përfshijnë:
  - a) Një përshkrim të njësisë organizative të shoqërisë, e cila do të jetë përgjegjëse për internalizimin sistematik;
  - b) Një përshkrim të rregullave dhe procedurave që do të ndiqen gjatë kryerjes së kësaj veprimtarie;
  - c) Të dhëna mbi personelin dhe cilësitë e tyre teknike, të caktuar për ushtrimin e këtij funksioni;
  - d) një përshkrim të sistemit që do të përdoret për publikimin e angazhimeve të detyrueshme për blerje dhe shitje;
  - e) një listë të instrumenteve financiare për të cilat shoqëria komisionere synon të veprojë si internalizues sistematik.
3. Autoriteti publikon listën e internalizuesve sistematikë dhe e përditëson atë vazhdimisht në faqen zyrtare të tij.



## Neni 19

### **Internalizuesi Sistematik për aksionet, dëftesat e depozitarit, ETF-të, certifikatat dhe instrumentet e tjera financiare të ngjashme**

1. Shoqëria komisionere trajtohet si internalizues sistematik në lidhje me çdo aksion, dëftesë depozitari, fond të tregtuar në bursë (ETF), certifikatë dhe instrumente të tjera financiare të ngjashme, në kushtet kur ekziston një treg likuid, kur ajo përmbush të gjitha kriteret e mëposhtme:
  - a) Në bazë të shpeshtësisë dhe sistematikës për instrumentet financiare, siç përcaktohet në nenin 3, pika 52 të Ligjit, gjatë 6 muajve të fundit:
    - i. numri i transaksioneve mbi banak (OTC) të kryera prej saj për llogari të vet kur ekzekuton urdhrat e klientit është i barabartë ose mbi 0,4 % të numrit total të transaksioneve në instrumentin financiar përkatës të kryera në çdo vend tregtimi, përfshirë tregtimin mbi banak (OTC) gjatë së njëjtës periudhë;
    - ii. transaksionet e kryera prej saj për llogari të vet gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientit në instrumentin financiar përkatës kryhen mesatarisht çdo ditë.
  - b) për instrumentin financiar, ku madhësia e transaksioneve mbi banak (OTC) të kryer prej saj për llogari të vet gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientit, gjatë 6 muajve të fundit, është e barabartë ose më e lartë sesa:
    - i. 15 % e volumit të tregtimit në atë instrument financiar të ekzekutuar nga shoqëria komisionere për llogari të vet duke ekzekutuar për llogari të klientëve ne raport me totalin e volumit të ekzekutuar në çdo vend tregtimi dhe transaksioneve mbi banak (OTC);
    - ii. 0,4 % e volumit total të tregtimit në atë instrument financiar të ekzekutuar në çdo vend tregtimi ose transaksioneve mbi banak (OTC).
2. Shoqëria komisionere trajtohet si internalizues sistematik në lidhje me çdo aksion, dëftesë depozitari, fond të tregtuar në bursë (ETF), certifikatë dhe instrumente të tjera financiare të ngjashme, në kushtet kur nuk ka një treg likuid, kur ajo përmbush të gjitha kriteret e mëposhtme:
  - a) Gjatë 6 muajve të fundit, në instrumentin financiar, transaksionet mbi banak (OTC) prej saj për llogari të vet gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientit kryhen mesatarisht çdo ditë;
  - b) Kërkesat e përcaktuara në pikën 1, shkronja b) të këtij neni.

## Neni 20

### **Internalizuesi sistematik për obligacionet**

1. Shoqëria komisionere do të bëhet një internalizues sistematik në lidhje me të gjitha obligacionet që i përkasin një klase obligacionesh të emetuara nga e njëjta njësi ekonomike ose nga çfarëdo njësie ekonomike brenda të njëjtit grup ku, në lidhje me çfarëdo obligacion të tillë, ajo internalizon në kushtet kur ekziston një treg likuid, sipas të gjithë kriterëve të mëposhtme:
  - a) Në një obligacion siç përcaktohet në nenin 3, pika 52 të Ligjit, ku gjatë 6 muajve të fundit:

- i. numri i transaksioneve mbi banak (OTC) të kryera prej saj për llogari të vet gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientit është i barabartë ose mbi 2,5% të numrit total të transaksioneve në obligacionin përkatës të ekzekutuar në çdo vend tregtimi ose transaksionet mbi banak (OTC) gjatë së njëjtës periudhë;
    - ii. numri i transaksioneve mbi banak (OTC) të kryera prej saj për llogari të vet gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientit në instrumentet financiare përkatëse kryhen mesatarisht një herë në javë;
  - b) Në një obligacion ku madhësia e transaksioneve mbi banak (OTC) të kryera prej saj për llogari të vet gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientit është, gjatë 6 muajve të fundit, e barabartë ose më e lartë sesa cilado nga sa vijon:
    - i. 25 % e volumit total të tregtimit në atë obligacion të ekzekutuar nga shoqëria komisionere për llogari të saj ose për llogari të klientëve dhe të ekzekutuar në një vend tregtimi ose transaksioneve mbi banak (OTC);
    - ii. 1 % e volumit total të tregtimit të obligacionit të ekzekutuar në çdo vend tregtimi ose transaksioneve mbi banak (OTC).
2. Shoqëria komisionere do të bëhet një internalizues sistematik në lidhje me të gjitha obligacionet që i përkasin një klase obligacionesh të emetuara nga e njëjta njësi ekonomike ose nga çfarëdo njësi ekonomike brenda të njëjtit grup ku, në lidhje me çfarëdo obligacion të tillë, ajo internalizon në kushtet kur nuk ka një treg likuid sipas të gjithë kriterëve të mëposhtme:
- a) Gjatë 6 muajve të fundit në një obligacion, transaksionet mbi banak (OTC) të kryera prej saj për llogari të vet gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientit kryhen mesatarisht një herë në javë;
  - b) Kërkesat e përcaktuara në pikën 1, shkronja b) të këtij neni.

## **Neni 21**

### **Internalizues sistematik për produktet financiare të strukturuar**

Shoqëria komisionere do të bëhet internalizues sistematik në lidhje me të gjitha produktet financiare të strukturuar që i përkasin një klase produktesh financiare të strukturuar të emetuara nga e njëjta njësi ekonomike ose nga çfarëdo njësi ekonomike brenda të njëjtit grup ku, në lidhje me çfarëdo produkti financiar të strukturuar të tillë, ajo internalizon sipas kriterëve të mëposhtme:

- a) Në një produkt financiar të strukturuar për të cilin ekziston një treg likuid, siç përcaktohet në nenin 3, pika 52 të Ligjit, ku gjatë 6 muajve të fundit:
  - i. numri i transaksioneve mbi banak (OTC) të kryera prej saj për llogari të vet kur ekzekuton urdhrat e klientëve është i barabartë ose mbi 4% e numrit total të transaksioneve në produktin përkatës financiar të strukturuar të kryer në çdo vend tregtimi ose transaksionet mbi banak (OTC) gjatë së njëjtës periudhë;

- ii. numri i transaksioneve mbi banak (OTC) të kryera prej saj për llogari të vet gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientëve në instrumentin financiar përkatës kryhen mesatarisht një herë në javë;
- b) Në një produkt financiar të strukturuar për të cilin nuk ka një treg likuid, ku gjatë 6 muajve të fundit të numrit të transaksioneve mbi banak (OTC) të kryera prej saj për llogari të vet gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientëve kryhen mesatarisht një herë në javë;
- c) Në një produkt financiar të strukturuar ku madhësia e transaksioneve mbi banak (OTC) të kryer nga ajo për llogari të vet gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientëve është, gjatë 6 muajve të fundit, e barabartë ose më e lartë sesa cilado nga sa vijon:
  - i. 30 % e volumit total të tregëtimit në atë produkt financiar të strukturuar të ekzekutuar nga shoqëria komisionere për llogari të saj ose në emër të klientëve dhe të ekzekutuar në një platformë tregtimi ose tregëtimit mbi banak (OTC);
  - ii. 2,25 % në atë produkt financiar të strukturuar të ekzekutuar në çdo vend tregtimi ose transaksionet mbi banak (OTC).

## **Neni 22**

### **Internalizuesi sistematik për derivativët**

Shoqëria komisionere bëhet një internalizues sistematik në lidhje me të gjithë derivativët që i përkasin një klase derivativësh ku, në lidhje me çdo derivativ të tillë, ajo internalizon sipas kritereve të mëposhtme:

- a) Në një derivativ për të cilin ekziston një treg likuid, siç përcaktohet në nenin 3, pika 52 të ligjit, kur gjatë 6 muajve të fundit:
  - i. numri i transaksioneve mbi banak (OTC) të kryera prej saj për llogari të vet gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientit është i barabartë ose mbi 2,5% të numrit total të transaksioneve në klasën përkatëse të derivativëve të kryera në çdo vend tregtimi ose OTC gjatë të njëjtës periudhë;
  - ii. transaksionet mbi banak (OTC) të kryera prej saj për llogari të vet gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientit në këtë klasë derivativësh kryhen mesatarisht një herë në javë;
- b) Në mënyrë të shpeshtë dhe sistematike në një derivativ për të cilin nuk ka një treg likuid, kur gjatë 6 muajve të fundit, transaksionet OTC të kryera prej saj për llogari të vet në klasën përkatëse të derivativit gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientit ndodh mesatarisht një herë në javë;
- c) Në mënyrë thelbësore në një derivativ ku madhësia e tregëtimit OTC të kryer nga ajo për llogari të vet gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientit është, gjatë 6 muajve të fundit, e barabartë ose më e lartë sesa cilado nga sa vijon:
  - i. 25 % e volumit total të tregëtimit në atë klasë derivativësh të ekzekutuar nga shoqëria komisionere për llogari të saj ose për llogari të klientëve dhe të ekzekutuar në një vend tregtimi ose transaksionet mbi banak (OTC); ose
  - ii. 1 % e volumit total të tregëtimit në atë klasë derivativësh të ekzekutuar në çdo vend tregtimi ose transaksionet mbi banak (OTC).

## Neni 23

### Internalizues sistematik për kuotat e lejuara të çlirimit të e gazrave serrë

Shoqëria komisionere do të bëhet internalizues sistematik në lidhje me kuotat e lejuara të çlirimit të gazrave serrë kur, në lidhje me çfarëdo instrument të tillë, ajo internalizon sipas kritereve të mëposhtme:

- a) Në kuotat e lejuara të çlirimit të gazrave serrë për të cilin ekziston një treg likuid kur gjatë 6 muajve të fundit:
  - i. numri i transaksioneve mbi banak (OTC) të kryera prej saj për llogari të vet gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientit është i barabartë ose mbi 4% e numrit total të transaksioneve në llojin përkatës të kuotat e lejuara të çlirimit të gazrave serrë të ekzekutuara në çdo vend tregtimi ose transaksioneve mbi banak (OTC) gjatë së njëjtës periudhë;
  - ii. numri i transaksioneve mbi banak (OTC) të kryera prej saj për llogari të vet gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientit në kuotat e lejuara të çlirimit të gazrave serrë kryhen mesatarisht një herë në javë;
- b) Në mënyrë të shpeshtë dhe sistematike në kuotat e lejuara të çlirimit të gazrave serrë për të cilin nuk ka një treg likuid, kur gjatë 6 muajve të fundit numri i transaksioneve mbi banak (OTC) të kryera prej saj për llogari të vet në llojin përkatës të kuotat e lejuara të çlirimit të gazrave serrë gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientit kryhen mesatarisht një herë në javë;
- c) Në kuotat e lejuara të çlirimit të gazrave serrë ku madhësia e transaksioneve mbi banak (OTC) të kryer nga ajo për llogari të vet gjatë ekzekutimit të urdhrave të klientit është, gjatë 6 muajve të fundit, e barabartë ose më e lartë sesa cilado nga sa vijon:
  - i. 30 % e volumit total të transaksioneve në kuotat e lejuara të çlirimit të gazrave serrë të ekzekutuara nga shoqëria komisionere për llogari të vet ose për llogari të klientëve dhe të ekzekutuara në një vend tregtimi ose transaksioneve mbi banak (OTC);
  - ii. 2,25 % e volumit total të transaksioneve në kuotat e lejuara të çlirimit të gazrave serrë të ekzekutuar në çdo vend tregtimi ose tregtimit mbi banak (OTC).

## Neni 24

### Periudhat përkatëse të vlerësimit

1. Kushtet e përcaktuara në nenin 19 deri në nenin 23 të kësaj rregulloreje do të vlerësohen çdo tre muaj dhe në bazë të të dhënave të 6 muajve të fundit.
2. Periudha e vlerësimit fillon në ditën e parë të punës të muajve janar, prill, korrik dhe tetor.
3. Instrumentet e sapo emetuara do të merren në konsideratë në vlerësim vetëm kur të dhënat historike mbulojnë një periudhë prej të paktën tre muajsh në rastin e aksioneve, dëftesave depozitarë, ETF-ve, certifikatave dhe instrumenteve të tjera financiare të ngjashme dhe

gjashtë javë në rastin e obligacioneve, produkteve të strukturuar financiare dhe derivativëve.

**Neni 25**  
**Kufijtë e paracaktuar**  
**Pushimi i veprimtarisë si internalizues sistematik**

1. Shoqëria komisionere pushon së vepruari si internalizues sistematik për një ose më shumë instrumente financiare nëse nuk plotësohet kriteret e përcaktuara në nenet 19-23 të kësaj rregulloreje.
2. Shoqëria komisionere, që pushon së vepruari si internalizues sistematik për një ose më shumë instrumente financiare, njofton përdoruesit dhe Autoritetin.

**SEKSIONI II**  
**Njoftimi**

**Neni 26**  
**Njoftimi i Autoritetit**

1. Shoqëritë komisionere, të cilat plotësojnë kriteret e përcaktuara në Ligj dhe në këtë rregullore për të qenë internalizues sistematik njoftojnë menjëherë me shkrim Autoritetin sipas modelit të paraqitur në Shtojcën IV.
2. Kur shoqëria komisionere, e cila trajtohet si internalizues sistematik në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligj dhe këtë rregullore pushon së vepruari si internalizues sistematik në një ose më shumë instrumente financiare, sipas përcaktimit të Ligjit dhe nenit 25 të kësaj rregulloreje, ajo duhet të njoftojë me shkrim dhe pa vonesë Autoritetin sipas modelit të përcaktuar në Shtojcën IV.
3. Shoqëritë komisionere duhet të ofrojnë prova kur njoftojnë Autoritetin për t'u trajtuar si internalizues sistematik ose kur pushojnë së vepruari si të tillë.

**KREU VIII**  
**DISPOZITA E FUNDIT**

**Neni 27**  
**Hyrja në fuqi**

kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë, me përjashtim të “Kreut VII” që i fillon efektet nga data 1 janar 2024.

**SHTOJCA I**  
**FORMULARI DHE PËRMBAJTJA E APLIKIMIT**

**[Identiteti dhe detajet e kontaktit të aplikantit]**

**[Lloji i Aplikimit: PSHT/POT]**

**[DATA E APLIKIMIT]**

**PËRMBLEDHJE**

**DEKLARATA E APLIKANTIT**

Me besimin tonë maksimal ne deklarojmë se të gjitha informacionet dhe të dhënat e vendosura në aplikim janë të sakta dhe korrekte dhe se asnjë informacion ose e dhënë nuk është hequr, të cilat ndikojnë në saktësinë dhe plotësinë e informacionit.

nënshkruar nga [përfaqësuesi i autorizuar i aplikantit]

**PËRGJEGJËSIA PËR INFORMACIONET QË PËRMBAN APLIKIMI**

Aplikanti pranon përgjegjësinë për informacionet dhe të dhënat e përfshira në këtë aplikim. Informacionet janë në përputhje me faktet dhe nuk lënë jashtë asnjë informacion që do të ulte rëndësinë e tij. Kur përdoren informacione nga burime të palëve të treta, këto informacione riprodhohen me saktësi.

**SEKSIONI 1 – Lloji i aplikimit**

Aplikimi për Licencimin PSHT [ ]	Aplikimi për Licencimin POT [ ]
----------------------------------	---------------------------------

**SEKSIONI 2 – Informacionet kryesore për aplikantin**

Zëri 1	Emri dhe forma ligjore e aplikantit
Zëri 1.1.	Rruga, numri i rrugës, kodi postar, qyteti dhe shteti

Zëri 1.2.	Ligji sipas të cilit ushtron veprimtarinë aplikanti
Zëri 1.3.	Shteti i themelimit të aplikantit

### SEKSIONI 3 – Informacione të dhëna nga aplikanti

Operatori përkatës për të cilin është dorëzuar aplikimi	Paragrafi përkatës i kësaj rregulloreje	Titulli i dokumentit	Referenca në dosje ku jepet informacioni, ose arsyet pse informacioni nuk është dhënë

### SHTOJCA II

**Formati i publikimit dhe komunikimit pranë Autoritetit nga operatori i PSHT/POT të vendimit për pezullimin ose heqjen nga tregtimi e instrumentit financiar dhe derivativëve të lidhur dhe të vendimit të tij për të hequr pezullimin e një instrumenti financiar dhe derivativëve të lidhur (kur është e zbatueshme)**

FUSHA	DETAJE PËR T’U RAPORTUAR
Data dhe ora e publikimit/komunikimit	
Qëllimi i vendimit	
Arsyet e vendimit	
Në fuqi që nga data	
Në fuqi deri në datën	
Në proces	

Vendi (et) e tregimit	
Emri i emetuesit të instrumentit	
Identifikimi i instrumentit	
Derivativë të lidhur	
Instrumente të tjera të lidhura	
Komente	



### SHTOJCA III

**Formati i publikimit dhe komunikimit nga ana e Autoritetit të vendimit për të pezulluar/hequr nga tregtimi një instrument financiar dhe derivatet e lidhura ose për të hequr pezullimin e një instrumenti financiar dhe derivativët e lidhur**

FUSHA	DETAJE PËR T'U RAPORTUAR
Autoriteti kompetent	
Operatori i vendit të tregimit si iniciator i vendimit	
Data dhe ora e publikimit/komunikimit	
Lloji i vendimit	
Arsyet për vendimin	
Në fuqi që nga data	
Në fuqi deri në	
Në proces	
Vendi(et) Tregimit	
Emri i emetuesit	
Identifikimi i instrumentit	
Derivativë të lidhur	
Instrumente të tjera të lidhura	
Komente	

## SHTOJCA IV

### **Modeli për njoftimin në Autoritet kur një shoqëri komisionere bëhet internalizues sistematik ose kur pushon së vepruari si internalizues sistematik**

[Emri i shoqërisë komisionere]

Ju informojmë se po [bëhemi / pushojmë veprimtarinë si] internalizues sistematik që nga data [ju lutemi shënoni datën]

Shpjegim:

Kjo fushë duhet të kontrollohet nëse kriteret për internalizim sistematik plotësohen për herë të parë ose nuk plotësohen më sepse kufijtë përkatës nuk janë tejkaluar më për asnjë instrument financiar përkatës. Kjo duhet t'i njoftohet Autoritetit pa vonesë.

Përcaktuese për vlerësimin e menjëhershmerisë së njoftimit është data e përfundimit të përlllogaritjeve, nga e cila nuk është tejkaluar vlera e pragut dhe marrja e këtij njoftimi nga Autoriteti.

Ju informojmë se po [bëhemi / pushojmë veprimtarinë si] Internalizues Sistematik që nga data [ju lutemi shënoni datën] për klasat e instrumenteve financiare që vijojnë (*ju lutemi përzgjidhni sipas rastit*):

#### **Instrumente të kapitalit:**

- Aksionet (SHR)
- Fondet e tregtuara në bursë (Exchange Traded Funds - ETF)
- Dëftesë depozitari (Depository Receipt - DPR)
- Certifikatat (CRF)
- Instrumente të tjera financiare *quasi-equity* (OTH)

#### **Instrumente që nuk i përkasin kapitalit:**

- Derivativë të titullzuar (SDR)
- Produkte financiare të strukturuar (SFP)
- Obligacione (BON)
- Mallra të tregtuara bursë (Exchange Traded Commodities - ETC)
- Instrumenta të tregtuara në bursa në formën e bondeve/produkteve të strukturuar (Exchange Traded Notes - ETN)

- Kuotat e e lejuara të çlirimit të gazrave serrë (Emission Allowances - EMA)
- Derivativë (DER)

*Shpjegim:*

Të gjitha klasat e aktiveve në të cilat aktiviteti si internalizues sistematik [do të ushtrohet / nuk ushtrohet më sepse asnjë instrument financiar përkatës nga kjo klasë aktivesh nuk i ka kaluar kufijtë përkatës në periudhën e fundit të vlerësimit që nga data e raportimit] duhet të jepen këtu.

Vendi dhe data, si dhe nënshkrimi i përfaqësuesit të autorizuar

---